



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 53.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 3, 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4; 47 paragrafi 1 dhe nenin 49 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nenin 9 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, Kuvendi i Komunës së Podujevës duke vendosur sipas propozimeve të paraqitura nga subjektet politike të Kuvendit dhe propozimeve nga Komunitetet jo shumicë, në procedurë të rishqyrtimit të aktit duke vepruar sipas Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr.020-92/6 të datës 23.04.2026, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2026, mori këtë,

V E N D I M **PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE**

Neni 1

Themelohet Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

1. **z.Ardi Hasani**, anëtar nga subjekti politik - LVV
2. **znj.Vlora Jashanica**, anëtare nga subjekti politik - LVV
3. **znj.Blerta Azemi - Berisha**, anëtare nga subjekti politik - LDK
4. **z.Besim Latifi**, anëtar nga subjekti politik - LDK
5. **z.Demokrat Hodolli**, anëtar nga subjekti politik - Guxo
6. **z.Rrahim Sejdiu**, anëtar nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Ashkali
7. **znj.Vlorjana Avdiu**, anëtare nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Ashkali
8. **z.Xhafer Ademi**, anëtar nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Ashkali
9. **znj.Dorontina Tahiri**, anëtare nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Ashkali
10. **z.Muhamet Sadiku**, anëtar nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Rom
11. **znj.Sevdije Mustafa**, anëtare nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Egjiptas

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlihet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual mund të bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Komitetit për Komunitete, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimin Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit, Rregulloren e punës së Komiteteve, dhe dispozitat tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 4

Kompensimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete, bëhet konform legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave.

Nr.Prot. 01-016/p1-0031716/26
Podujevë, datë; 28 maj 2026

